



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.213/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevi kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Hasan Shala, anëtarë me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkritazi me ankesën e organizatës BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 16.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa organizates BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë me shenjen ZL.Anr. 213/2017 e datës 13.10.2017, me të cilën ka kërkuar që ti shqiptohet dënimi me gjobë subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Prizren, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatet.

A r s y e t i m

Organizata BIRN dhe IKS me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 13.10.2017, me të cilën pretendon se kandidati për kryetar të Komunës së Prizrenit, nga radhët e subjektit politik LVV, Mytahir Haskuka, pretendohet se ka shkelur rregullën zgjedhore 13/2013 neni 5.2 duke përfshirë fëmijë në tubimin zgjedhor të mbajtur në shkollën e lagjes Arbana të Komunës së Prizrenit më datë 12.10.2017. Më tej ka pretenduar në ankesë se në bazë të fotove të publikuara nga kandidati në faqen e tij të facebook-ut më dt.12.10.2017 vërehet prezenca e personave nën moshën 18 vjeçare, duke shkelur kështu nenin 5.2 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur 2 (dy) fotografi në lidhje me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) të datës 14.10.2017, theksoj se menjëherë pasi që ka pranuar urdhrin nga PZAP-ja, ka ndërmarr masat përmirësuese lidhur me këtë çështje dhe ka larguar fotografën e publikuar në facebook, po ashtu ka theksuar se i ka informuar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e saj për dispozitat e Kodit të Mirësjelljes së Subjekteve Politike dhe nevojat për të zbatuar dispozitat e tij. Andaj LVV ka ndërmarr të gjitha masat për të evituar shkeljet e mundshme nga anëtarët, mbështetësit apo kandidatët për zgjedhjet lokale. Gjithashtu, LVV ka theksuar se në atë tubim si dhe në fotografën e bashkangjitura ankesës shihet vetëm një fëmijë me nënën e saj, e jo siç pretendon parashtruesi i ankesës se aty shihen fëmijë nën moshën 18 vjeçare.

Në mbështetje të pretendimeve ka bashkangjitur 2 (dy) fotografi ku shihet se është larguar fotografia nga rrjeti social facebook.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljet e pretenduara të Kodit të Mirësjelljes nga ana e subjektit politike LVV, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të Kodit të Mirësjelljes pasi që fëmija në foto shihet se është në shoqërim të personit madhor rindit dhe kjo nuk ka asnjë element të shfrytëzimit të fëmijëve lidhur me fushatën zgjedhore të pretenduar në ankesë, sepse fëmija i paraqitur në foto nuk ka asnjë shenjë të ndonjë subjekti politik.

Andaj duke u bazuar në arsyet e dhëna më lartë dhe në kuptim të nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Zl.Anr.213/2017 më datë 16.10.2017.

Kryesuesi Panelit
Adnan Konushevc



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.